

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm nr.2002/2 Neni 13.5, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr.03/L-068, neni 5 paragrafi (d), UA nga MASHT-i , nr 17/2009, DAKRS -Junik, shpallë:

KONKURS

Për këto vende të lira të punës për vitin shkollor 2012/13

Shkolla e Mesme e Ulët „Rexhep Kadrijaj”- Rastavicë

- 1. Një (1) mësues klase**

Gjimnazi „Kuvendi i Junikut ”- Junik

- 1. Një (1) profesor për lëndën e Gjuhës Angleze**
- 2. Një (1) profesor për lëndën e Fizikës**

KUSHTET:

- Për vendet e punës për mësimdhënës kërkohet përgatitja profesionale përkatëse,**
- Në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijn në konsiderim kandidatët me kualifikim të përafërt,**

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

- Diploma (çertifikata) në origjinal ose fotokopje e vërtetuar nga organi përkatës,
- Çertifikata e lindjes,
- Leja njoftimit e fotokopjuar,
- Dëshmi për përvojën e punës,
- Dëshmi për trajnimet arsimore etj.
- Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik,
- Dokumentat e pakompletuara si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim,
- Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes,
- Për ditën e intervistimit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

Drejtori:

Musë Krasniqi

Duke u bazuar në Ligjin e shërbyesve Civil nr 03/L-149 neni 11, neni 18 paragrafi 1, Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010, Statutin e Komunës neni 61, si dhe pas autorizimit të Ministrisë së Administratës Publike, datë:09.07.2012 nr.protokoli 2172, Komuna e Junikut shpall këtë:

**K O N K U R S
PËR PLOTESIMIN E VENDEVE TE
PUNES**

**I. Drejtoria për administratë të
përgjithshme**

- 1. POZITA: përkthyes i gjuhëve zyrtare
KOEFIICIENTI: 7
LLOJI I POZITES: i karrieres
POZITA FUNKSIONALE:
nepunes civil i nivelit profesional
ORARI I PUNES: 40 orë në javë
PËRGJEGJESIA**

MBIKEQYRESE: jo

MBIKEQYRJA: Drejtori

DETYRAT E PUNËS:

- Ben përckthimin e materialeve prezantuese për komunën – informatorëve , buletineve dhe materialeve te tjera promovuese,
- Përckthen aplikacionet e drejtorive te komunës për investime te drejtuara ne donator te huaj,
- Përckthen materialet e pranuar nga donatorete, investitorët dhe përfaqësuesit e ndryshëm te huaj,
- Ben përckthimin e kërkesave te kryetarit drejtuar përfaqësuesve te ndryshëm ndërkombëtar dhe prezanton ne takimet e kryetarit me përfaqësues te huaj ne rolin e përckthyesit.

KUSHTET: Përgatitja superiore, njohja e gjuhëve zyrtare te Kosovës.

II. DREJTIRIA URBANIZEM KADASTER DHE MJEDIS

1. POZITA: Zyrtarë për ndërtim dhe infrastrukturë

KOEFICIENTI: 7

LLOJI I POZITES: i karrieres

POZITA FUNKSIONALE:

nepunes civil i nivelit profesional

ORARI I PUNES: 40 orë në javë

PËRGJEGJESIA

MBIKEQYRESE: jo

MBIKEQYRJA: Drejtori

DETYRAT E PUNËS:

- Zbaton ligjin dhe vendimet tjera të aplikueshme nga fushëveprimi i Planifikimit Urban,**
- Ndiemon në hartimin e akteve të përgjithshme normative të Planifikimit Urban dhe rural,**
- Bashkëpunon me institucionet e Komunës, me rastin e përgatitjes dhe hartimit të PZHK, PZHU, PRRU dhe**

**planeve tjera në harmoni me Planin
Hapësinor të Kosovës,**

- Përgjegjës për ndërtim si ngritja, instalimi, rikonstruktimi, rinovimi, zgjerimi, ndryshimi (ndërrim i destinimit), rrënimi i objektit ndërtimor, duke përjashtuar punët për mirëmbajtjen e ndërtimeve ekzistuese dhe punimeve të vogla të specifikuara nga asambleja me rregullore apo vendim komunal, të cilat kanë leje të përkohshme apo nuk kanë,**
- Merr pjesë aktive në procedurat e planifikimit të hapësirës dhe rregullimit të tokës ndërtimore, planeve dhe programeve nga kjo lëmi,**
- Këshillon palët për procedurën dhe mënyrën e realizimit të të drejtave nga lëmi i ndërtimit, kryen edhe detyra tjera nga fushëveprimi i vet dhe lëmi i rregullimit të hapësirës, urbanizmit, ndërtimit dhe mbrojtjes së ambientit,**
- Mbikëqyr vazhdimisht gjendjen e furnizimit ujit të pijshëm,**
- Ben analiza rreth gjendjes së ujit të pijshëm,**

- **Mbikëqyr dhe përcjell trajtimin e ujerave te zeza,**
- **Harton plane për konsum te energjisë,**
- **Harton planet për ofiqiencë në sektorin publik dhe privat,**
- **Ben raportet e bilancit te konsumit te energjisë,**
- **Ben planin për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe urbane,**
- **Kryen edhe punë tjera nga fushë-veprimtaria dhe pozita e tij sipas urdhrit të eprori.**

KUSHTET: Diploma universitare në lëmin e Arkitekturës, Ndërtimtarisë ose lëmi të ngjashme.

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe

rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 e cila e rregullon rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Data e shpalljes se konkursit: 11.07.2012.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Formularët e aplikimit mund të merren në zyrën e pritjes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në zyrën e pritjes në objektin e Komunës kati i parë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe certifikata tjera mbi trajnimet e kryera.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e

ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë në numrin e telefonit 0390/370-987.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Udhëheqësja e personelit:
Venera Shala

Projekti për Zhvillim të Turizmit "Mirësevini në Dukagjin" është i financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt zbatohet nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) në bashkëpunim me Komunitet Gjakoë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog, dhe ka për qëllim që të kontribuojë në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e biznesit në turizëm duke mbështetur zhvillimin e mëtutjeshëm të resurseve njerëzore & përmirësimin e aseteve kulturore në regjionin Perëndim të Kosovës.

Prandaj, CHWB në bashkëpunim me Komunitet Gjakoë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog është në

kërkim të 20 ndërtesave tradicionale

(kullë, shtëpi qytetare, etj)

të cilat do të bëhen pjesë e rrjetit të **produktit turistik** në Komunitet përfituese

(Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog)

Ndërtesat do të rinovohen pjesërisht në kuadër të projektit. Rinovimi përfshin rinovimin dhe adaptimin e shtëpisë për funksionim si produkt turistik (p.sh 'bujtinë'). Intervenimi në rinovim të shtëpive tradicionale mund të përfshijë (por nuk limitohet): (i)përmirësimin e hapësirave të fjetjes; (ii)rregullimin e hapësirave të higjienës; (iii)intervenime në dekoracionet karakteristike; (iv)ndërtimi i infrastrukturës ndihmëse; (v)rregullimi i qasjes në ndërtesë ose (vi)përforsimet e strukturës së ndërtesës;...etj. Projekti do të mbulojë koston e rinovimit deri në maksimum **10,000€** për ndërtesë. Kontributi i pronarëve në bashkë-financim të rinovimit është i mirëpritur dhe do të jetë kriter në seleksionim të objekteve.

Kushtet për aplikim:

1. Shtëpia duhet të jetë së paku 50 vjet e vjetër dhe të ketë së paku 100m2 të shfrytëzueshme.
2. Shtëpia duhet të jetë brenda territorit të Komunitet përfituese Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog.
3. Ofertuesit duhet të jenë pronarë legal të ndërtesës.
4. Përshkrimi i shkruar lidhur me idetë e pronarit/shfrytëzuesit për qëllimin e investimit. Ky përshkrim duhet të shpjegojë idetë se si ai/ajo do ta vë në funksion ndërtesën si produkt turistik (maksimum 300 fjalë).

Të gjitha këto kushte janë obligative!

Kriteret për vlerësim do të marrin parasysh:

- Gjendjen e ndërtesës (gjendja më e mirë konstruktive do të vlerësohet më shumë).
- Përshkrimi i funksionit (mënyra e qëndrueshme e gjenerimit të të hyrave dhe punësimit do të vlerësohet më shumë).
- Sigurimin e resurseve shtesë nga pronari ose donatorët (resurset mund të jenë fonde buxhetore ose fuqi punëtore).

Ftohen pronarët e *shtëpive tradicionale* me interes në zhvillim të produktit turistik 'bujtinave' nga Komunitet përfituese (Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog) të tërheqin dhe dorëzojnë formularët e plotësuar [*i.Formulari për Aplikim & ii.Formulari për përshkrim*] në Zyrën e CHWB-së në Prishtinë (Qyteza Pejton, Rruga R. Zogoviq nr.8; Tel.: 038 243 918), ose në Pejë (Dede Gjo Luli nr.6; Tel.:039 421 325) ose në email adresën kosovo@chwb.org. Gjithashtu, te dy formularët mund të merren nga webfaqja <http://chwbkosovo.org/>. Afati fundit për dorëzimin e formularit është **06 Prill 2012**.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës neni 5 pika d), UA nga MASHT-i , nr 3/2009, dhe Statutit të Komunës, Udhëheqësja e personelit me datë: 07.03.2012, shpallë:

K O N K U R S

I. Për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës fillore dhe e mesme e ulët „Rexhep Kadrijaj “ në Rastavicë

Kushtet:

**Kontrata: 4 vjeçare,
Përvoja: 3 vjet përvojë pune,
Kualifikimi: Të kenë kryer njërin nga fakultetet përkatëse të licencuara,**

të Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve private të licencuara nga MASHT.

Raporton tek: Te Drejtori i DKA-së,

Orari: I plotë.

Paga: 359.00€

Dokumentacioni i kërkuar:

- **Certifikatën e lindjes,**
- **Diplomën e fakultetit të kryer,**
- **Dëshminë për përvojën e punës,**
- **CV-n sipas modelit të MASHT-it,**
- **Rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibil,**
- **Programin zhvillimor të institucioneve edukativo- arsimore dhe aftësuese për të cilën ka konkurruar (më së shumti 5 faqe tekst me 30 rreshta të letrës të formatit A-4),**
- **Certifikatat e trajnimeve të zhvilluara,**
- **Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.**

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren në Komunën e Junikut, në zyrën e DKA-së, në Junik. Kandidatet të cilët do të ftohen në intervistë medoemos duhet të sjellin në shikim dokumentet origjinale. Nëse kemi numër të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e zgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej femrave dhe meshkujve prej të gjitha komuniteteve. Konkursi ngel i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Udhëheqësja e personelit:

Venera Shala